



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 716/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevcu dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesimit të votave me post në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) - KQZ, për Zgjedhjet për Kryetar të Komunës dhe Kuvend Komunal në Dragash të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr ankesa Anr.716/2021 e datës 24.10.2021, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesimit të votave me post në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) - KQZ, për Zgjedhjet për Kryetar të Komunës dhe Kuvend Komunal në Dragash të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2021, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur në PZAP ankesën Anr.716/2021 në të cilën pretendon se votat e dërguara me postë për Komunën e Dragashit të dërguara në KQZ-QNR vërehet se në listën e të regjistruarve në këtë komunë një numër i madh i votuesve të regjistruar fillimisht e më pas i atyre që kanë votuar, votat e tyre i kanë dërguar nga Maqedonia e Veriut ose nga Mali i Zi dhe janë kryesisht të komunitetit goran. Parashtruesi i ankesës thekson se nga informatat që kanë mbledhur vëzhguesit e tyre dhe aktivistët e tjerë në komunën e Dragashit dhe nga kontaktet direkte ose me familjarët e tyre që jetojnë në Dragash kanë përpiluar një listë sipas të cilës një numër prej rreth 66 qytetarëve me emër dhe mbiemër dhe të dhëna tjera personale të cilët

kanë votuar ose votat e tyre sipas regjistrit të KQZ-së i kanë dërguar nga Maqedonia dhe Mali i Zi, jetojnë në shtete të ndryshme të botës. Andaj të njëjtit kërkojnë që para fillimit të numërimit të këtyre votave në QNR –KQZ, fillimisht të verifikohet në tersi lista e votuesve të aprovuar për Komunën e Dragashit dhe më pastaj të filloj numërimi i atyre votave të ardhura nga Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, si dëshmi kësaj ankese i ka bashkangjitur: raportin e Sekretariatit të KQZ-së, listën e votuesve të aprovuar nga KQZ për komunën e Dragashit, si dhe listën e përpiluar dhe e hulumtuar nga aktivistët e LDK-së.

Ndërsa në po të njëjtën ditë me datën 24.10.2021 subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur pranë PZAP-it kërkesën me nr. Protokolli Anr.716/3 për tërheqje të ankesës Anr.716/2021 të datës 24.10.2021 lidhur me administrimin e numërimit QNR sa i përket procesit të votimit përmes postës në zgjedhjet për kryetar dhe kuvend komunal të Dragashit, për arsye se numërimi i administrimit veç se ka filluar, andaj edhe kërkojnë tërheqjen e saj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 6 paragrafi 2 të Rregullës Nr.02/2015 të PZAP-it si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.716/2021 më datën 25.10.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.